

*Në emër të Zotit, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotë
Paqja e bekimet qofshin për Profetin Muhamed*

Letër e hapur Shenjtërisë së Tij Papës Benedikt i XVI-të

*Në emër të Zotit, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotë
“Mos debatoni me njerëzit e Librit, përveçse në mënyrën më të mirë...”
(Kurani Fisnik, Sure Ankebut 29:46)*

Shenjtëria Juaj,

Duke iu referuar ligjëratës suaj në Universitetin e Regensburg-ut në Gjermani, datë 12 shtator 2006, e menduam të përshtatshme, në frymën e shkëmbimit të hapur, t'i përgjigjemi përdorimit prej jush të debatit midis perandorit Manuel Paleologu i II-të dhe “një persi të ditur”, si pikënisje për një diskutim mbi marrdhëniet midis arsyes dhe besimit. Ndërsa përsëritësia përjekjen tuaj për t'iu kundërvënë sundimit të pozitivizmit dhe materializmit në jetën njerëzore, na duhet të veçojmë disa gabime në mënyrën në të cilën ju përmendët Islamit si një argument kundër përdorimit të drejtë të arsyes, si edhe disa pasaktësi në pohimet që parashtruat në mbështetje të pikëpamjes tuaj.

Nuk ka detyrim në fe

Ju përmendët se “sipas ekspertëve” verseti kuranor i cili fillon me “*Nuk ka detyrim në fe...*” (Bekare 2:256) i përket një periudhe të hershme kur Profeti “ishte ende pafuqi dhe nën kërcënime”, por kjo është e pasaktë. Në fakt ky verset pranohet se i përket periudhës së revelatës kuranore që lidhet me fuqizimin në rritje të bashkësisë së re muslimane, si në aspektin politik, ashtu edhe në atë ushtarak. “*Nuk ka detyrim në fe*” nuk është një urdhër që u drejtohet muslimanëve për të qëndruar të papërkulur përballë dëshirës së persekutorëve të tyre për t'i detyruar të braktisin besimin, por është një përkujtues ndaj vetë muslimanëve që, me të fituarit e pushtetit, të mos detyronin zemrën e askujt drejt besimit. “*Nuk ka detyrim në fe...*” u drejtohet atyre që janë në pozita force dhe jo dobësie. Komentarët më të hershëm të Kuranit (si ai i el Tabariut) dëftojnë qartë se disa muslimanë të Medinës dëshironin t'i detyronin fëmijët e tyre që të ktheheshin nga Judaizmi apo Krishtërimi në Islam, dhe verseti kuranor ishte posaçërisht një përgjigje për ta që të **mos** provonin të detyronin fëmijët e tyre që të konvertoheshin në Islam. Për më tepër, muslimanët janë të udhëzuar edhe prej verseleve të tilla si: “*E ti thuaj: E vërteta është prej Zotit tuaj, e kush të dojë le të besojë, e kush të dojë le të mohojë*” (Kehf 18:29) si dhe “*Thuaj: "O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju adhuron; as ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj. Dhe unë nuk do të jem adhurues i asaj çka ju adhuron! Por edhe ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj. Ju keni fenë tuaj, e unë kam fenë time"*”. (Kafirun 109:1-6)

Transcendenca e Zotit

Ju gjithashtu thoni se “sipas mësimave të Islamit, Zoti është absolutisht transcendent”, një thjeshtësim reduktues ky, i cili mund të shpjegohet në ngatërresë. Kurani deklaron: “*Nuk i shëmbëllen Atij asgjë.*” (Shura 42:11) por gjithashtu deklaron edhe “*Zoti është drita e qiejve dhe tokës.*” (Nur 24:35) dhe “*Ne jemi më afër tij se damari i qafës së tij.*” (Kaf 50:16) dhe “*Ai është i Pari dhe i Fundmi, i Dukshmi dhe i Padukshmi.*” (Hadid 57:3) dhe “*Ai është me ju*

kudo që të jeni” (Hadid 57:4) dhe “Kahdo që të ktheheni është Fytyra e Zotit.” (Bekare 2:115). Gjithashtu, le të kujtojmë thënien e Profetit, e cila deklaroi se Zoti thotë: “Kur e dua atë (adhuruesin), unë jam dëgjimi me të cilin ai dëgjon, shikimi me të cilin ai sheh, dora me të cilën ai prek dhe këmba me të cilën ai ecën.” (Sahihu i Buhariut nr.6502, Kitab el rikak.)

Në traditën shpirtërore, teologjike dhe filozofike të Islamit, mendimtari që ju përmendni, Ibën Hazmi (vdiq më 1069) është një personalitet me vlera, por tepër marginal, i cili i përkiste shkollës juridike Zahirie, shkollë e cila nuk ndiqet më nga askush në botën e sotme muslimane. Nëse kërkojmë formulime klasike mbi doktrinën e transcendencës, figura shumë herë më të rëndësishme për muslimanët janë të tilla si ajo e Gazaliut (vdiq më 1111) apo e shumë të tjerëve, të cilët janë tejet më ndikues dhe përfaqësues në fushën e besimit islam sesa Ibën Hazmi.

Ju citoni logjikimin, sipas të cilit, meqë perandori bizantin ishte “i formësuar nga filozofia greke” ideja se “Zoti nuk është i kënaqur me gjakun” është e “vetëkuptueshme” për të, kurse mësimi islamik përmbi transcendencën e Zotit vendoset përballë si një shembull kundër kësaj ideje. Të thuhet se për muslimanët “Vullneti i Zotit nuk kushtëzohet me asnjë prej kategorive tona” është po ashtu një thjeshtësim reduktues, i cili mund të shpjëjë drejt keqkuptimeve. Në Islam, Zoti ka shumë emra, midis të cilëve Mëshirëplotë, i Drejtë, Gjithëshikues, Gjithëdëgjues, i Gjithëdijshëm, i Dashur dhe i Mirë. Bindja e plotë në Njësinë e Zotit dhe se “Dhe Atij askush nuk i përngjason.” (Ihlas 112:4) nuk ka i shtyrë muslimanët që të mohojnë cilësitë të cilat Zoti i ka përshkruar Vetes dhe (disa prej) krijesave të Tij (duke lënë mënjanë për çastin nocionin e “kategorive”, një term i cili kërkon shumë qartësime në këtë kontekst.) Për sa ka të bëjë me Vullnetin e Tij, të dilet në përfundimin se muslimanët besojnë në një Zot kapriçioz i cili mundet të dëshirojë apo jo të na urdhërojë drejt të keqes, është të harrosh se Zoti thotë në Kuran: “Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve dhe ndalon nga flligështia, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon në mënyrë që të merrni mësim.” (Nahl 16:90) Njëkohësisht, kjo është harrosh se Zoti thotë në Kuran: “Ai ia përcaktoi mëshirën Vetes.” (En’am 6:12) dhe se “Mëshira Ime ka përfshirë gjithçka.” (A’raf 7:156). Fjala e përdorur për mëshirën, *rahmet*, mund të përkthehet gjithashtu si dashuri, mirësi, dhembshuri. Nga kjo fjalë, *rahmet*, rrjedh formula e shenjtë të cilën muslimanët e përdorin çdo ditë: *Në emër të Zotit të Gjithmëshirshëm, Mëshirëplotë. A nuk është e vetëkuptueshme se derdhja e gjakut të pafajshëm del kudër mëshirës dhe dhembshurisë?*

Të përdorurit e arsyes

Tradita islamike është e pasur në eksplorime mbi natyrën e inteligjencës njerëzore dhe marrdhënien e saj me Natyrën e Zotit dhe Vullnetin e Tij, duke përfshirë këtu edhe çështje të asaj çka është e vetëkuptueshme dhe çka jo. Megjithatë, dikotomia mes “arsyes” në njërën anë, dhe “besimit” në tjetrën, nuk ekziston në të njëjtën formë në botëkuptimin musliman. Në vend të kësaj, muslimanët kanë pranuar në mënyrën e tyre forcën dhe kufizimet e inteligjencës njerëzore, duke njohur një hierarki të dijes në të cilën arsyeja zë një vënd qendror. Janë dy ekstreme të cilat tradita islamike në përgjithsi ka arritur t’i shmangë: njëri është të bërit e arsytimit analitik, gjykatës përfundimtar të së vërtetës, dhe tjetri ekstrem është mohimi i fuqisë njerëzore në të kuptuarit e çështjeve përfundimtare. Për çka është më e rëndësishme, muslimanët gjatë kohërave, në eksplorimet e tyre intelektuale më të pjekura dhe mbizotëruese, kanë mirëmbajtur një harmoni midis të vërtetave kuranore dhe kërkesave të mendjes njerëzore, pa sakrifikuar njërën për hir të tjetrës. Zoti thotë: “Ne do t’i bëjmë ata të shohin shenjat Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri sa t’u bëhet e qartë se kjo është e vërteta.” (Fusilet 41:53). Njëra prej këtyre shumë shenjave brenda nesh, është vetë arsyeja, mbi të cilën dhe me të cilën Zoti na fton të meditojmë, si rrugë për të njohur të vërtetën.

Ç'është "Lufta e shenjtë"?

Do të dëshironim të theksonim se "lufta e shenjtë" është një term i cili nuk ekziston në asnjë prej gjuhëve të popujve muslimanë. Xhihad, duhet nënvizuar, do të thotë përpjekje, veçanërisht përpjekje në rrugën e Zotit. Kjo përpjekje mund të marrë shumë forma, përfshirë këtu edhe përdorimin e forcës. Ndonëse një xhihad mund të jetë i shenjtë, në sensin e të qenit i drejtuar kah një ideal i shenjtë, ai nuk mund të jetë nevojshëmrisht një "luftë". Për më tepër, është për t'u shënuar se Manuel Paleologu i II-të thotë se "dhuna" është e kundërt me natyrën e Zotit, ndërkaj që vetë Krishti përdori dhunë kundër fajdexhinjve në tempull, dhe tha "*Mos mendoni se unë erdha të sjell paqen mbi tokë; nuk erdha të sjell paqen, por shpatën...*" (Mateu 10:34-36). Kur Zoti përmbysi faraonin, mos veproji vallë kundër natyrës së Tij? Mbase perandori kishte për qëllim të thoshte se mizoria, vrazhdësia dhe agresioni janë kundër Vullnetit të Zotit, e në këtë rast, ligji klasik dhe tradicional i Xhihadit në Islam, do ta kishte konfirmuar plotësisht fjalën e tij.

Ju thoni se "natyrisht perandori i njihte udhëzimet e zhvilluara më vonë dhe të shënuara në Kuran, sa i përket luftës së shenjtë". Gjithsesi, ashtu si theksuam më lart në lidhje me versetin "*Nuk ka detyrim në fe*", udhëzimet e sipërpërmendura nuk ishin aspak të mëvonshme. Veç kësaj, përkufizimet e perandorit mbi konvertimin e dhunshëm, tregojnë se ai nuk dinte as si janë dhe as si kanë qenë përherë këto udhëzime.

Rregullat autoritative dhe tradicionale islamike të luftës mund të përmbliidhen në principet e mëposhtme:

- 1) Civilët joluftues nuk janë objektiva luftarakë të lejuar apo të legjitimuar. Kjo është theksuar në mënyrë të shkoqur dhe rregullisht që nga Profeti, shokët e tij dhe mësimi i traditës.
- 2) Besimi fetar si i tillë nuk bën që dikush të jetë objekt sulmi. Bashkësia muslimane e origjinës luftonte kundër paganëve, të cilët i kishin përzënë edhe prej shtëpive të tyre muslimanët, i kishin persekutuar, torturuar dhe vrarë. Që pas kësaj periudhe, fushatat fitimtare islame ishin të natyrës politike.
- 3) Muslimanët mund dhe duhet të jetojnë paqësisht me fqinjët e tyre "*Në qoftë se ata anojnë kah paqja, ano edhe ti kah ajo, e mbështetu në Allahun.*" (Enfal 8:61) Megjithatë, kjo nuk përjashton vetëmbrojtjen e ligjshme dhe ruajtjen e sovranitetit.

Muslimanët e kanë të detyrueshme t'i zbatojnë këto rregulla po aq sa e kanë të detyrueshme të qëndrojnë larg vjedhjes dhe adulterit. Nëse një fe ushtron rol rregullator mbi luftën dhe përkufizon rrethanat kur ajo është e nevojshme dhe e drejtë, kjo nuk e bën këtë fe luftëdashëse, po aq sa ushtrimi i rolit rregullator në seksualitet nuk e bën një fe epshore. Nëse disa nënçmojnë një traditë të gjatë dhe të konsoliduar bindshëm në këmbim të ëndrrave utopike ku qëllimi justifikon mjetet, ata e kanë bërë këtë të udhëhequr vetëm nga mendja e tyre, pa miratim nga Zoti, Profeti i Tij apo nga mësimi i traditës. Zoti thotë në Kuranin e Shenjtë: "*Dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë.*" (Maide 5:8). Në këtë kontekst ne deklarojmë se vrasja më 17 shtator e një murgeshe të pafajshme katolike në Somali, si edhe çdo tjetër akt i ngjashëm dhune perverse "si reagim ndaj" ligjëratës suaj, është krejtësisht joislamik dhe dënohet prej nesh totalisht.

Konvertimi i dhunshëm

Koncepti se muslimanët janë të urdhëruar të përhapin fenë e tyre “me shpatë” apo se Islami u përhap përgjithësisht “me shpatë” është diçka që nuk mbështetet në fakte. Sigurisht, Islami si një entitet *politik* u përhap pjesërisht si rezultat i fushatave fitimtare, por pjesa më e madhe e shpërhapjes së tij që fryt i predikimit dhe veprimtarisë misionare. Mësimet islame nuk porosisin që popullsitë nën pushtetin musliman të detyrohen apo shtrëngohen që të ndryshojnë fenë. Kështu, shumica e banorëve të territoreve të para të fituara nga muslimanët, mbetën për shekuj me rradhë jomuslimanë. Nëse do të kishin dëshiruar muslimanët t’i konvertonin njerëzit me forcë, nuk do të kishte mbetur në këmbë asnjë kishë apo sinagogë e vetme në botën islame. Urdhëresa “*Nuk ka detyrim në fe*” ka sot të njëjtin kuptim që kishte edhe atëherë. Në vetvete, fakti i të qenit jomusliman nuk ka përbërë kurrë ndonjë *casus belli* të legjitimuar qoftë nga ligji apo qoftë nga besimi islam. Sa i përket ligjeve të luftës, historia tregon se disa muslimanë i kanë dhunuar parimet islame në rastin e konvertimit me forcë apo trajtimit të bashkësive të tjera fetare, por historia gjithashtu tregon se këto janë vetëm përjashtime që përforcojnë rregullin. Ne pajtohemi në mënyrë të prerë se të detyrosh të tjerët të besojnë, nëse një gjë e tillë do të ishte realisht e mundur, nuk ka pëlqimin e Zotit dhe Zotit nuk i pëlqen gjaku. Ne vërtetë besojmë, atë çka muslimanet kane besuar gjithmone se “*Kush vret një njeri pa patur vrarë ai ndonjë tjetër dhe pa patur bërë ndonjë shkatërrim në tokë, është si të kishte vrarë gjithë njerëzinë.*” (Maide 5:32).

Diçka e re?

Ju citoni perandorin të thote se “çdo e re” e sjellë nga Profeti ishte “e keqe dhe johumane, ashtu si dhe mandati nën të cilin ai pretendonte të përhapte me shpatë fenë që predikonte”. Veç faktit të përmendur më sipër, se asnjë urdhëresë e tillë nuk ka ekzistuar ndonjëherë në Islam, perandori nuk mund të arrinte të kuptonte se Profeti kurrë nuk pretendoi se po sillte ndonjë gjë krejtësisht të re. Zoti thotë në Kuranin e Shenjtë: “*Ty (Muhamedi) nuk po të thuhet tjetër përveç asaj që u është thënë të dërguarve para teje.*” (Fusilet 41:43) dhe Thuaj (Muhamedi): “*Unë nuk jam gjë e re ndër të dërguarit (e Zotit), e nuk e di se çka do të bëhet me mua e as me ju. Unë nuk ndjek tjetër veç asaj që më shpallet; unë nuk jam tjetër veçse këshillues që ju tërheq vërejtjen.*” (Ahkaf 46:9). Kështu të besuarit në një Zot nuk është pronë e ndonjë bashkësie fetare. Sipas mësimit islamik, të gjithë profetët e vërtetë i kanë predikuar të njëjtën të vërtetë popujve të ndryshëm në vende të ndryshme. Ligjet mund të jenë të ndryshme, por e vërteta e pandryshueshme.

“Ekspertët”

Ju i referoheni diku në nënyrë jospesifike “ekspertëve” mbi Islamin dhe gjithashtu citoni me emër dy studiues katolikë, profesorin Adel Teodor Khuri si edhe profesorin e asociuar Roger Arnaldez. Mjafton këtu të thuhet se ndërkaq që shumë muslimanë mendojnë se ka mjaft jomuslimanë apo katolikë mirëkuptues të cilët mund të konsiderohen vërtetë “ekspertë” të Islamit, me sa dijmë ne, muslimanët nuk i njohin për të tillë “ekspertët” që ju përmendni, e as nuk u kanë njohur atyre të drejtën e përfaqsimin të pikëpamjeve të tyre. Në 25 shtator 2006, ju përforcuat deklaratën tuaj të rëndësishme të datës 20 gusht 2005 në Këln, duke thënë se “Dialogu ndërfaqësor dhe ndërkulturor midis të krishterëve dhe muslimanëve, nuk mund të reduktohet në një shtojcë opcionale. Ai në fakt është një nevojë jetike nga e cila varet, në një masë të madhe, e ardhmja jonë.” Ndërkaq që biem plotësisht dakord me ju, na duket se një pjesë e madhe e thelbit të dialogut ndërfaqësor është të përpiqemi të dëgjojmë zërat e atyre me të cilët faktikisht jemi duke dialoguar, dhe jo thjesht ato të bindjeve tona.

Krishtërimi dhe Islami

Krishtërimi dhe Islami janë përkatësisht feja e parë dhe e dytë për nga përhapja në botë dhe në histori. Të krishterët dhe muslimanët sipas të dhënave përbëjnë përkatësisht një të tretën dhe një të pestën e njerëzimit. Së bashku ata formojnë më shumë se 55% të popullsisë botërore, duke e bërë kështu marrdhënien midis bashkësive të tyre faktorin më të rëndësishëm për një paqe të mirëfilltë nëpër botë. Duke qenë udheqës i mëse një miliard katolikëve dhe shembull moral për shumë të tjerë nëpër glob, zëri juaj është ndoshta më influencuesi në vijimin e ecurisë së kësaj marrdhënieje drejt mirëkuptimit të ndërsjelltë. Ne ndajmë së bashku dëshirën tuaj për dialog të hapur dhe të sinqertë dhe jemi të ndërgjegjshëm për sa i përket rëndësisë së tij në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur. Mbi këtë dialog të sinqertë e të hapur ne shpresojmë të vazhdojmë ndërtimin e marrdhënieve paqësore dhe miqësore të bazuara këto mbi respektin reciprok, drejtësinë dhe mbi atë çka është në thelb e përbashkët në traditën tonë abrahamike, veçanërisht në “dy urdhëresat e mëdha” që gjenden tek Ungjilli sipas Markut, 12:29-31 (dhe në një variant tjetër, edhe tek Mateu 22:37-40), ku thuhet: “Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot” ; dhe: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!”. Ky është i pari urdhërim”; Dhe i dyti i ngjan këtij: “Duaje të afërmin tënd porsì vetveten”. Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se këta”.

Muslimanët po ashtu vlerësojnë fjalët e mëposhtme nga Koncili i Dytë i Vatikanit:

“Kisha ka gjithashtu konsideratë të lartë për muslimanët. Ata adhurojnë Zotin, i cili është një, i gjallë dhe në jetë, i mëshirshëm dhe i gjithëpushtetshëm, Krijuesi i qiellit dhe i tokës, i cili i ka folur njerëzimit. Ata përpiqen t’i nënshtrohen pa kushte vendimeve të mistershme të Zotit, ashtu si iu nënshtroa planit të Zotit edhe Abrahami, tek besimi i të cilit muslimanet me zell lidhin besimin e tyre. Ndonëse nuk e pranojnë atë si Zot, ata e nderojnë Jesusin si profet; respektojnë Nënë e tij të Virgjër, të cilën herë pas here e invokojnë me përkushtim. Veç kësaj, ata janë ne pritje të Ditës e Gjykimit dhe të shpërblimit të Zotit pas ringjalljes së të vdekurve. Për këtë arsye ata vlerësojnë së tepërmi të jetuarit me ndershmëri dhe adhurojnë Zotin, veçanërisht nëpërmjet rrugës së lutjes, bamirësisë dhe agjërimit.” (*Nostra Aetate*, 28 tetor 1965)

Dhe po ashtu vlerësojnë fjalët e të ndjerit, Papës Gjon Pali II, të cilin shumë muslimanë e vlerësonin dhe e respektonin:

“Ne të krishterët pranojmë me gëzim vlerat e përbashkëta fetare që ndajmë me Islamin. Sot dëshiroj të përsëris atë çka i thashë rinisë muslimanë disa vite më parë në Kazablanka: “Ne besojmë të njëjtin Zot, të vetmin Zot, Zotin e gjallë, Zotin që krijoi botën dhe që shpie krijesat e tij drejt përsosjes” (*Insegnamenti*, VIII/2, [1985], f. 497, cituar gjatë një audience të hapur në 5 maj 1999).

Muslimanët gjithashtu e vlerësuan shprehjen e pazakontë të keqardhjes suaj, si dhe sqarimin dhe garancinë (më 17 shator) se citimi juaj nuk pasqyron opinionin tuaj personal, ashtu si dhe rikonfirmimin e dokumentit konciliar *Nostra Aetate* nga ana e Sekretarit të Shtetit, kardinalit Tarcisio Bertone (më 16 shtator). Dhe në fund, muslimanët vlerësuan shprehjen tuaj të “respektit të plotë dhe të thellë për gjithë muslimanët” në takimin e 25 shtatorit me një grup ambasadorësh të vendeve islame. Shpresojmë se të gjithë ne do të shmangim gabimet e të shkuarës dhe do ta jetojmë së bashku të ardhmen në paqe, pranim të ndërsjelltë dhe respekt.

Gjithë falenderimet i përkasin Zotit, dhe nuk ka fuqi as forcë veçse prej Zotit.

© 2006

Nënshkruar:
(sipas rregullit alfabetik)

E. T. *Alame* Abdullah bin Mahfuz bin Bejah,
Profesor, Universiteti i Mbretit Abd Al-Aziz, Arabi Saudite
Ish-zëvendëspresident, Ministër i Drejtësisë, Ministër i Arsimit dhe Ministër i Çështjeve Fetare, Mauritani

Profesor Dr. *Alame* Muhamed Seyid Ramadan Buti,
Dekan i Fakultetit të Fesë, Universiteti i Damaskut, Siri

E. T. Profesor Dr. Mustafa Çagrëcë,
Kryemyftiu i Stambollit

E.T. Shejh Profesor Dr. Mustafa Çeriç,
Kryemyftiu dhe Kreu i Ulemave të Bosnjës dhe Hercegovinës

E.T. Shejh Ravil Gainutdin,
Kryemyftiu i Rosisë

E.T. Shejh Nexhad Grabus
Kryemyftiu i Sllovenisë

Shejh *El Habib* Ali Meshhur bin Muhamed bin Selim bin Hafiz
Imami i Xhamisë së Tarimit dhe Kreu i Këshillit të Fetvasë, Tarim, Jemen

Shejh *El Habib* Omer bin Muhamed bin Selim bin Hafiz
Dekan i Universitetit Dar El Mustafa, Tarim, Jemen

Profesor Dr. Faruk Hamadah
Profesor i Shkencave të Traditës, Universiteti Muhamedi i V-të, Marok

Shejh Hamza Jusuf Hanson
Themeluesi dhe Drejtori i Institutit “Zaytuna”, Kaliforni, Sh. B. A.

E.T. Shejh Dr. Ahmed Berdredin Hasun
Kryemyftiu i Republikës së Sirisë

Profesor Dr. Abla Muhamed Kahlavi
Dekane e Studimeve Islamike dhe Arabe, Universiteti i Ez’her (Kolegji Femëror), Egjipt

Profesor Dr. Muhamed Hashim Kemali
Dekan, Instituti Ndërkombëtar i Mendimit dhe Qyteterimit Islamik (ISTAC), Malejzi
Profesor i Ligjit dhe Jurisprudencës Islame, Universiteti Ndërkombëtar Islamik, Malejzi

Shejh Nuh Ha Mim Keller
Shejh i Tarikatit Shazili dhe Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor i Institutit Al el Bejt për Mendimin Islamik (Jordani), Sh. B. A.

E.T. Shejh Ahmed el Halili
Kryemyftiu i Sulltanatit të Omanit

Dr. Shejh Izedin Ibrahim
Këshilltar i Çështjeve Kulturore në Kryeministri, Emiratet e Bashkuara Arabe

E.T. Shejh Muhamed Sadik Muhamed Jusuf
Kryemyftiu i Uzbekistanit

Shejh Dr. Ahmed Kubeisi
Themelues i Organizatës së Ulemave, Irak

Alame Shejh Muhamed bin Muhamed El Mansuri
Autoritet i Lartë (Marxha) i Muslimanëve Zeidinj, Jemen

Shejh Ebu Bekër Ahmed El Milibari
Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës së Ehli Sunetit, Indi

E.T. Dr. *Moulai* Abdelkebir el Alavi El Mudgari
Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Bejt Mal Kuds el Sherif
Ish-Ministër i Çështjeve Fetare, Marok

E.T. Shejh Ahmed Hasim Muzadi
Kryetari i Përgjithshëm i Nahdat el Ulema, Indonezi

E.T. Profesor Dr. Seid Hosein Nasr
Profesor Universiteti për Studimet Islame, George Washington University, Uashington D.C., Sh. B. A.

E.T. Shejh Shevki Omerbasiç
Kryemyftiu i Kroacisë

H.H. Myftiu i së Drejtës Muhamed Taki Osmani
Zëvendëspresident i Dar el Ulum, Karaçi, Pakistan

Shejh M. Ikbali Sulam
Nënshef i Përgjithshëm, Nahdat el Ulema, Indonezi

Shejh Dr. Tarik Sveidan
Drejtor i Përgjithshëm i Kanalit Satelitor *Risalah*

E.T. Dr. Muhamed Abdelgafar el Sherif
Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Çështjeve Fetare, Kuvajt

Dr. Muhamed Elvani el Sherif
Kreu i Akademisë Evropiane për Shkencat dhe Kulturën Islamike, Bruksel, Belgjikë

Profesor Dr. N. T. Princ Gazi bin Muhamed bin Talal
Kreu i Këshillit të Institutit të Al el Bejt për Mendimin Islamik, Jordani

E.T. Ajatollah Muhamed Ali Tas'hiri
Sektetar i Përgjithshëm i Asamblesë Botërore për Afrimin e Shkollave të Mendimit Islamik (WAPIST), Iran

E.T. Shejh Naim Tërnavë
Kryemyftiu i Kosovës

E.T. Dr. Abdylaziz Osman el Tuejxhiri
Drejtor i Përgjithshëm i Organizatës Islamike të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (ISESCO), Marok

E.T. Shejh Muamer Zukorliç
Myftiu i Sanxhakut, Bosnjë

E.T. Profesor Dr. Omer Xhah
Sekretari i Këshillit të Dijetarëve Muslimanë, Gambia
Profesor i Qytetërimit dhe Mendimit Islamik, Universiteti i Gambias

Shejh *El Habib* Ali Zein el Abedin El Xhifri
Themeluesi dhe Drejtori i “Institutit Taba”, Emiratet e Bashkuara Arabe

E.T. Shejh Profesor Dr. Ali Xhuma
Kryemyftiu i Republikës së Egjiptit

Shejh Abdelhakim Murad Winter
Ligjërues “Shaykh Zayed” në Studime Islamike, Divinity School, University of Cambridge, Mbretëria e
Bashkuar
Drejtor i Fondacionit Akademik Musliman, Mbretëria e Bashkuar